

# 1. Abstrakt

Njohja me hapësirën fiziko-gjeografike dhe socio-ekonomike si dhe shpërndarja e hapësirave rekreative në komunën e Prizrenit është me interes të hulumtohet, të vlerësohet dhe të jepen rekomandime pasi që paraqet një zonë me biodiversitet si nga aspekti natyror ashtu dhe demografik e kulturoro-historik.

Stresi të cilin njeriu e përjeton gjatë punës së përditëshme e shton nevojën që të largohet nga rutina e përditëshme qoftë vetëm për një ditë ose disa orë për të qëndruar në vende të gjelbëruara, të pastërta dhe larg shamatës urbane.

Prizreni i ofron këto kushte ngase pozita e volitshme gjeografike dhe karakteristikat e shumëta natyrore, numri i madh i objekteve kulturoro-historike, folklori i begatshëm, prania e disa etniciteteve, tradita e mikërpitjes janë disa nga faktorët e shumtë

që e bëjnë Prizrenin si qytetin më të preferuar nga vizitorët brenda dhe jashtë vendit.

Prandaj, nga nevoja e trajtimit të kësaj teme vendosëm që të bëjmë një hulumtim të zonës në fjalë me shpresën që sa do pak do japim kontribut në planifikim dhe rekomandim të zonave – hapësirave rekreative për komunën e Prizrenit.

Krahas zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë në shek. XIX – XX ka ndryshuar edhe menyra e të jetuarit tonë duke shtyrë në rritjen e kërkesave për shfrytëzimin më të mirë të kohës së lirë kryesisht në vende të gjelbruara dhe larg ndotjes dhe zhurmës. Meqenëse komuna e Prizrenit posedon një numër të madh të hapësirave rekreative, shfrytëzimi i tyre do të ndikonte në energji pozitive në çdo person që në mënyrë të drejtëpërdrejtë do ta përmirësonte kualitetin e punës dhe të jetës në përgjithësi.

Vetdijësimi i qytetarëve për ambientin ku jetojnë do të ndikonte pozitivisht në ruajtjen e

hapësirave ekzistuese, rritjen e tyre dhe krijimin e hapësirave të reja rekreative. Prizrenit nuk i mjafton koha, atij i duhet një veprim i shpejtë në mënyrë që të ruaj mozaikun e panoramës së qytetit, duke iu ikur ndërtimeve të egra të cilat kanë marrë hov të madh kohëve të fundit.